



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS  
KËSHILLI BASHKIAK

**VENDIM**

Nr.7, datë 28.01.2021

**PËR**

**MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VKB NR. 599, DATË 11.03.2019 “PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT VJETOR PREJ 8.800.000 LEKË PËR PROKURIMIN E SIPËRMARRJES PRIVATE TË SHËRBIMIT TË MIRËMBAJTJES DHE RUAJTJES SË VARREZAVE PUBLIKE TË QYTETIT TË DURRËSIT”**

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr. 9220, datë 15.4.2004 “Për shërbimin publik të varrimit” i ndryshuar, Udhëzimi nr. 2, datë 19.7.2004 “Mbi përcaktimin dhe plotësimin e modelit të regjistrit të shërbimit të varrimit”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 199, datë 10.07.2014, “Për dhënien e miratimit Bashkisë Durrës të zhvillojë procedurat e prokurimit publik për kalimin në sipërmarrje të shërbimeve publike të mirëmbajtjes dhe ruajtjes së varrezave publike të qytetit të Durrësit”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 599, datë 11.03.2019 “Për miratimin e përdorimit të fondit vjetor prej 8.800.000 lekë për prokurimin e sipërmarrjes private të shërbimit të mirëmbajtjes dhe ruajtjes së varrezave publike të qytetit të Durrësit”, Vendimit nr. 12, datë 25.03.2020 dhe nr. 1, datë 22.01.2021 të Këshillit Drejtues të Ndërmarrjes së Shërbimeve Komunale Durrës, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 123, datë 24.12.2020, “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2021 si edhe projekt buxhetin afatmesëm të Bashkisë Durrës për vitet 2021-2023” miratuar nga Prefekti i Qarkut Durrës me Aktin nr. 1103/7, datë. 31.12.2020, sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimeve dhe Punëve Publike, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetares së Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D O S I :**


1. Sektori funeral me drejtim ekonomik, që funksionon pranë NSHK Durrës, të mbyllë aktivitetin e tij dhe shërbimet e tij të kalojnë me operator ekonomik, së bashku me shërbimet

e mirëmbajtjes dhe ruajtjes së varrezave publike të qytetit të Durrësit sipas VKB nr. 599, datë 11.03.2019.


2. Ndyshimin e Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 599, datë 11.03.2019 “Për miratimin e përdorimit të fondit vjetor prej 8.800.000 lekë për prokurimin e sipërmarrjes private të shërbimit të mirëmbajtjes dhe ruajtjes së varrezave publike të qytetit të Durrësit” dhe akordimin e këtij fondi në vlerën 37.600.000 lekë sipas buxhetit të miratuar dhe në funksion të kalimit të shërbimit funeral dhe mirëmbajtjes me operator ekonomik.
3. Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale Durrës të ndjekë procedurat ligjore dhe administrative deri në mbylljen e aktivitetit të këtij sektori.
4. Proçedura e prokurimit të shërbimit të varrimit, të mirëmbajtjes dhe ruajtjes së varrezave publike të qytetit të Durrësit do të kryhet nga Bashkia Durrës me fond limit vjetor 37.600.000 lekë, sipas planifikimit të buxhetit 3- vjeçar afatmesëm 2021- 2023.
5. Fatura e arkëtimit të tarifës së shërbimit funeral të miratuar sipas VKB nr. 98, datë 30.09.2020, do të lëshohet dhe arkëtohet nga Drejtoria e Shërbimeve pranë Bashkisë Durrës.
6. Të gjithë punonjësit e këtij sektori me drejtim ekonomik të punësohen nga Operatori Ekonomik fitues i kontratës së prokurimit.
7. Drejtoria e Shërbimeve, Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale dhe Operatori Ekonomik fitues i kontratës së prokurimit të zbatojnë Udhëzimin nr. 2, datë 19.7.2004 “Mbi përcaktimin dhe plotësimin e modelit të regjistrit të shërbimit të varrimit”.
8. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve dhe Punëve Publike, Drejtoria e Buxhetit, Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale dhe Njësia e Prokurimit.
9. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

**KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**



**U shpall sot me datë 28.01.2021**



2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 89/prot.  
7.

Durrës, më 02 02 .2021



**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK  
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 07 datë 28.01.2021 “Për miratimin e ndryshimit të VKB Nr 599 datë 11.03.2019 Për miratimin e përdorimit të fondit vjetor prej 8.800.000 lekë për prokurimin e sipërmarjes private të shërbimit të mirëmbajtjes dhe ruajtjes së varrezave publike të qytetit të Durrësit”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**

**ROLAND NASTO**

